

Data 22.02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Gërmime Arkeologjike i Mozaikut dhe Rrënojave të Tjera Antike në Shkollën e Mesme Gjergj Kastrioti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Kodi CPV**
45112450-4 - Punime gërmimi në vende arkeologjike

VLERA E FONDIT LIMIT: 13’811’500 (trembëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, **pa tvsh.**

Argumentim:

“Gërmime Arkeologjike i Mozaikut dhe Rrënojave të Tjera Antike në Shkollën e Mesme Gjergj Kastrioti”

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr.32, datë 09.02.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

Dokumentave sipas Buxhetit të Bashkisë, për fondit limit,

Shqyrtoi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktura, objekt i këtij prokurimi.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”neni 36.

PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE :

Për përlloraritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM, Nr 285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, sipas të cilit:

Në përlloraritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

- a) çmimet e tregut; ose/dhe
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara

Në përfundim të punes se grupit u vërejt se:

Grupi i punes u bazua ne: projektin dhe preventivin per projekt zbatimin e objektit:

“Gërmime Arkeologjike i Mozaikut dhe Rrënojave të Tjera Antike në Shkollën e Mesme Gjergj Kastrioti”

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit te mbledhur të zërave te punimeve, rezultoi se:

Vlera e përgjithshme e kontratës për prokurimin me titull:

“Gërmime Arkeologjike i Mozaikut dhe Rrënojave të Tjera Antike në Shkollën e Mesme Gjergj Kastrioti”

rezultoi të jetë **13 811 500 lekë pa tvsh.**

Mbështetur në rezultatin e sipër nxjerë, Komisioni **me unanimitet,**

V E N D O S I :

Të përcaktojë Vlerën Limit të Kontratës; Për një shumë prej 13 811 500 **lekë** neto pa TVSH,

Afati i realizimit të punimeve është 60 dite pune, sipas grafikut te punimeve.

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuara, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohesh në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 13’000’000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kerkesa e mesiperme eshte bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure,si dhe mbeshetet ne ne nenin 77, pika 3, e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43,b.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin 9920 date 19.05.2008, Per Procedurat Tatimore ,neni 64 Deklarata Tatimore

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave

vendore” i ndryshuar , si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kerkese bazohet ne Ligjin nr.9632,date 30.10.2006 ,Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga cdo njesi e qeverisjes vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 6’500’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 26’000’000 lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vërtetime të lëshuara nga një autoritet/ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohet: ,Vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenin 39, pika 5 ”Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kulturës, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- A2 Sondazh Arkeologjik;
- A3 Gërmim Arkeologjik;

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë 'staf kryesor' dhe “staf mbështetës”. Me ‘staf kryesor’ do të kuptohet stafi teknik dhe menaxhues, i cili është thelbësor në këtë detyrë. Stafi kryesor duhet të identifikohet qartësisht si ‘staf kryesor’.

-Kërkohe të paraqiten CV-të dhe licencat individuale e të gjithë pjesëtarëve të stafit kryesor.

Në këtë staf duhet të jenë:

- 1 Arkeolog
- 1 Topograf
- 1 Restaurator mozaikësh

Licensat profesionale të stafit përgjegjës kryesor për zbatimin e kontratës, për kategoritë kryesore më poshtë:

Arkeologu – Udhëheqës i Grupit për kryerjen e punës “Gërmime Arkeologjike i Mozaikut dhe Rrënojave të Tjera Antike në Shkollën e Mesme Gjergj Kastrioti”:

- a) *Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshijë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologji, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njësuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;*
- b) *Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 20 vjet si drejtues projektsh arkeologjike në qendra të rëndësishme të Shqipërisë që kanë statusin e mbrojtjes nga Ligji Nr. 27/2018 për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë. Eksperienca të jetë e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion te projektit te miratuar. Njohuria dhe*

eksperienca profesionale në lidhje me monumentet arkeologjike të qarkut të Durrësit konsiderohet si kriter plotësues;

- c) *Kryerja e kërkimeve shkencore në fushën e arkeologjisë do të konsiderohet si kriter plotësues.*

Argumentimi:

Arkeologu udheheqës i grupit, kujdeset për realizimin e gërmimit arkeologjik, përgatitjen e raportit dhe mbrojtjen e rezultateve të gërmimit pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Përgatit dhe rekomandimet/Sugjerimet për vijimin e mëtejshëm për projektin e shkollës. Mbikëqyr gjithë punën që kryhet nga stafi mbështetës teknik.

Restaurator mozaikësh

- a. *Të zotërojë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshijë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologji ose histori, të licencuar në fushën e restaurimit sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njësuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;*
- b. *Të kenë eksperiencë si autor/bashkëautor në të paktën 10 (dhjetë) projekte për restaurimin e mozaikëve, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.*

Argumentimi:

Restauratori i mozaikut është përgjegjës për trajtimin e mozaikut in situ dhe konservimin e tij pas përfundimit të gërmimit arkeologjik. Përgatit skedën teknike të mozaikut së bashku me rekomandimet për ruajtjen dhe ekspozimin e mudshëm të tij.

Topografi,

duhet të ketë kompetencat e mëposhtme dhe të dorëzojë dokumentet dhe dëshmitë respektive:

- a) *Diploma Master Shkencor ose diplomë të integruar të nivelit të dytë në profilin Inxhinier Topograf;*
- b) *Licencë profesionale në projektim (ose dokumente të tjera të ngjashme sipas vendit të origjinës);*
- c) *Të paktën 3 vite eksperiencë pune në çështje të ngjashme: ekperiencë lokale, rajonale ose në vendet e Bashkimit Europian;*
- d) *Eksperienca të mëparshme në projekte dhe disiplina të ngjashme me të;*
- e) *CV, në të cilën të theksohet eksperienca në projekte të ngjashme.*

Argumentimi:

-Eksperti topograf është përgjegjës për rilevimin e strukturave dhe stratigrafise horizontale e vertikale të sitit arkeologjik. Përgatit planimetritë e nevojshme për hartimin e raportit përfundimtar arkeologjik dhe bazën e të dhënave me kuotat e gërmimit

Për arkeologun drejtues projekti:

Licensë individuale/person juridik për veprimtari arkeologjike:

- A1, A2, A3- Vëzhgim arkeologjik/ Sondazh arkeologjik/ Gërmim arkeologjik

Për restauratorin e mozaikëve:

Licencë profesionale në fushën e restaurimit sipas kategorive të përcaktuara në VKM për licencat në restaurim;

- ZN/1 – Zbatim në konservim dhe restaurim mozaikësh;

Për inxhinierin topograf:

Licensë Profesionale Individuale/Person Juridik në fushën e projektimit me kategoritë

- a- Rivelime inxhinierike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

*Listë e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, shoqëruar me CV-të e tyre, licencat/certifikatat profesionale për **stafin kryesor**, sipas kategorive të përcaktuara në pikën më lart dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ose kontratat përkatëse të punës.*

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.3. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës**, si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|----|
| - Arkeolog | 7 |
| - Punëtor të thjeshtë | 10 |
| - Specialist konservimi | 1 |
| - Manovrator | 1 |

Kriteret për stafin mbështetës të arkeologëve

Kërkohet të paraqiten CV-të dhe licenca (nëse disponojnë) e të gjithë pjesëtarëve të stafit mbështetës:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit master profesional apo shkencor, apo diplomë të integruar të nivelit të dytë (përfshijë rastet kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore), në profilin arkeologjik, trashëgimi kulturore të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njësuar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;*
- b) Të kenë eksperiencë si pjesëmarrës 5 (pesë) projekte për veprimtari arkeologjike, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit dhe me dokumentacion të projektit të miratuar.*

Argumentimi:

-7 arkeologë si staf ndihmës janë përgjegjës për kryerjen e punës teknike për realizimin e gërmimit arkeologjik të ndarë në 7 kuadrate në sheshin e përcaktuar për kryerjen e gërmimit arkeologjik. Mbiqyrin punën e puntoreve, selekcionojnë materialin arkeologjik, dokumentojnë stratigrafine dhe përgatisin raporte ditore të cilat ja përcjellin Drejtuesit të projektit.

-Punëtorët e thjeshtë si staf ndihmës nevojiten për kryerjen e punës fizike ngarkim, shkarkim, montim armaturash, pastrim i materialeve të panevojshme dhe punë të tjera ndihmuese gjatë procesit të gërmimit arkeologjik.

-Specialisti i konservimit si staf ndihmës për gjetjet e imëta është përgjegjës për trajtimin dhe restaurimin e materialit arkeologjik që zbulohet në gërmim. Proces që përfshin punën në terren dhe në laborator. Përgatit skedat teknike të objekteve me vlera për ekspozim dhe studim, deri në dorëzimin e tyre pranë institucioneve përgjegjëse të Trashëgimise Kulturore.

-Manovratori nevojitet për drejtimin e mjetit të punës për gërmim.

Për stafin mbështetës duhet të paraqiten: Kontratat e punës ose marrëveshje bashkëpunimi për angazhimin në objektin në fjalë, CV-të, diploma për kualifikimin përkatës.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

.....

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 22 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri prej 22 punonjës përfshin: 10 punëtorë të thjeshtë + personat që janë stafi i kualifikuar, drejtues mjete etj, të përmendur më lart.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit përmbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Lloji Makinerive	SASIA
Eskavator me kovë pa dhëmbëza	1 copë

Argumentimi:

-Eskavatori nevojitet për gërmimin e dherave me qëllim zbulimin e lamenteve arkeologjike si mozaiku dhe linjat e mureve të gjetura

Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Çertifikata e Transportit të mallrave/Liçenca, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

2.3. 8 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave”**

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri	Bashkia Durrës
Adresa	Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës
Tel/Faks	052 22 23 10
E-mail	info@durres.gov.al

Ueb-faqe www.durres.gov.al

- 2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur, Punë
- 3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-96181-02-22-2024
- 4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** “Gërmime Arkeologjike i Mozaikut dhe Rrënojave të Tjera Antike në Shkollën e Mesme Gjergj Kastrioti”
- 5.Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV 45112450-4** Punime gërmimi në vende arkeologjike
- 6. Fondi limit:** 13’811’500 (trembëdhjetë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, pa tvsh.
- 7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 60** (ditë)
- 8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 11.03.2024 Ora 10.00

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anetarët e njesise kane akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit